




Republika e Kosovës


Republika Kosovo/Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Zyra për Informim



-III- Nr. I prot. 5 Më 03.01.2020
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Raporti i punës së zyrës për Informim Janar-Dhjetor 2019

Përmbajtja:

1. Raporti narrativ për vitin 2019.....	2-3
2. Tabela e aktiviteteve.....	4
3. Aktivitetet e muajit Janar.....	4-5
4. Aktivitetet e muajit Shkurt.....	5-6
5. Aktivitetet e muajit Mars.....	6-7
6. Aktivitetet e muajit Prill.....	7-8
7. Aktivitetet e muajit Maj.....	8-10
8. Aktivitetet e muajit Qershor.....	10-11
9. Aktivitetet e muajit Korrik.....	11-12
10. Aktivitetet e muajit Gusht.....	12-13
11. Aktivitetet e muajit Shtator.....	13-14
12. Aktivitetet e muajit Tetor.....	14-15
13. Aktivitetet e muajit Nëntor.....	15-16
14. Aktivitetet e muajit Dhjetor.....	16-17

-Zyra për Informim aktivitetet i zhvillon në kuadër të zyrës së Kryetarit të komunë, duke u bazuar edhe në statutin e komunës, Rregulloren komunale për Transparencë dhe Planin Komunal i Veprimit për Transparencë.

-Me vendim të kryetarit jam caktuar person për shqyrtimin fillestar për Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike dhe se gjatë kësaj periudhe raportuese janë pranuar 22 Kërkesa për Qasje në Dokumentet Publike, dhe se nuk ka pasur asnjë kërkesë që është refuzuar dhe rrjedhimisht të gjitha kërkesat kanë marrë përgjigje pozitive nga Drejtorët e Drejtorive dhe zyrtarët e Sektorëve ku janë bërë kërkesat.

-Kryetari i komunës përmes vendimit të nënshkruar me 27/06/2019 me numër të protokollit 251, me ka caktuar kryesues të komisionit për pranimin teknik të punëve në projektin "Shërbimet e transmetimit të Kuvendit dhe shërbime të tjera për Komunën e Rahovecit, lidhur me këtë projekt raportet e pranuar nga Radio Aktiv, janë përgatitur me kohë dhe të njëjtit janë dërguar për pagesë në drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

-Gjatë kësaj periudhe raportuese janë përgatitur dokumente të cilat kanë të bëjnë me rritjen e performancës, transparencës dhe llogaridhënies siç janë: Planin Komunal i Veprimit për Transparencë 2019-2023, Rregullorja Komunale për Transparencë NR.03/2019 dhe Strategjia Avokuese për Komunën e Rahovecit.

-Gjatë gjithë kësaj periudhe raportuese Zyra për Informim në komunën e Rahovecit, është angazhuar në informimin sa më objektiv dhe të shpejtë për zhvillimet aktuale të Institucioneve komunale.

-Zyra për informim duke u bazuar edhe në planin e punës së saj i ka dërguar ftesa mediave lokale dhe atyre qendrore për përcjelljen e aktiviteteve të kryetarit, drejtorive, kuvendit dhe zyrave tjera të komunës sonë për të njoftuar publikun e gjerë për zhvillimet e gjithmbarshme në komunën e Rahovecit. Gjitha këto aktivitete, janë pasqyruar në publikim në Web faqen e komunës <https://kk.rks-gov.net/rahovec/>.

-Zyra për Informim, në vazhdimësi ka njoftuar opinionin e gjerë më zhvillimet aktuale përmes Web-faqes zyrtare <https://kk.rks-gov.net/rahovec/> në të cilën janë postuar lajmet ditore, ndërsa njoftimet, shpalljet e konkurset e ndryshme të institucioneve komunale të Rahovecit, janë bërë publike në bashkëpunim me dy zyrtarët e IT-së. Poashtu gjatë gjithë vitit në bashkëpunim dy zyrtarët e IT-së, kemi publikuar dokumente të cilat kanë për qëllim, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies siç janë: Raporte financiare, dokumente të ndryshme të drejtorive, plane të punës së qeverisë komunale, raporte periodike të qeverisë komunale si dhe broshura të ndryshme.

-Një bashkëpunim të ndërsjellët dhe shumë të mirë, është vazhduar me mediat lokale dhe ato qendrore, përmes adresave elektronike, gjitha mediave të shkruara, elektronike dhe agjencive të lajmeve u janë dërguar lajmet dhe fotot për ngjarjet nga komuna e Rahovecit.

-Zyra për Informim ka përcjell gjitha aktivitetet e kryetarit të komunës, apo edhe zyrtarëve të tjerë komunal në terren, janë përcjellë të gjitha seancat e Kuvendit Komunal për të cilat me kohë janë njoftuar edhe gazetarët, të gjitha mbledhjet e Komitetit për Politik e Financa për të cilat janë njoftuar me kohë edhe gazetarët dhe mbledhjet e Komitetit për Komunitete.

-Mbledhjet e Kuvendit janë transmetuar në kohë reale në programin që ka komuna e Rahovecit në Youtub, poashtu mbledhjet janë transmetuar direkt edhe nga Radio Aktiv, ndërsa aktivitetet tjera komunale janë përcjell dhe transmetuar gjithashtu në Radio Aktiv që kanë qenë të kontraktuara dhe Zyra për Informim i ka monitoruar gjatë transmetimit.

-Gjatë kësaj periudhe, jam marrë edhe me plotësimin e dokumenteve dhe dhënien e komenteve, në dokumentet e pranuar nga OJQ-të të ndryshme të cilat kohë pas kohe, kanë publikuar raporte lidhur me transparencën dhe llogaridhënien e komunës së Rahovecit. Si rezultat i përgjigjes me kohë, është rritur përqindja e vlerësimit lidhur me transparencën dhe llogaridhënien e komunës së Rahovecit për vitin 2019.

-Pas kërkesës së MAPL-së për përgatitjen e profilit të komunës, kam dhënë kontributin tim në përgatitjen e këtij dokumenti, dokument i cili është i rëndësishëm për komunën e Rahovecit.

-Gjatë gjithë kësaj periudhe raportuese Zyra për Informim në komunën e Rahovecit, është angazhuar në informimin sa më objektiv dhe të shpejtë për zhvillimet aktuale të Institucioneve komunale.

-Deri në këtë periudhë raportuese, kam marrë pjesë në 16 takime-punëtori që kryesisht kanë pasur të bëjnë me transparencë dhe llogaridhënie komunale dhe që janë organizuar nga OSCE, IKAP dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës.

Në këtë tabelë, mund ti gjeni statistikën për numrin e lajmeve, njoftimeve, ftesave, thirrjeve, vendimeve, konkurseve, ankandeve, debateve dhe kërkesat për Qasje në Dokumente Publike (QDP) të cilat janë publikuar në uebfaqen zyrtare të komunës së Rahovecit për vitin 2019.

Muaji	Lajme	Njoftime	Ftesa	Thirrje	Vendime	Konkurse	Ankande	Debate	QDP	Numri i përgjithshëm i aktiviteteve për muaj
1. Janar	34	10	0	0	21	12	1	2	5	85
2. Shkurt	22	3	1	0	29	4	0	0	2	61
3. Mars	25	11	0	1	31	5	0	2	1	76
4. Prill	25	15	0	2	24	8	0	1	3	78
5. Maj	32	12	2	0	40	5	1	0	1	93
6. Qershor	30	7	1	0	28	2	0	3	1	72
7. Korrik	18	6	1	0	48	4	0	0	0	77
8. Gusht	18	6	1	1	28	3	0	1	2	60
9. Shtator	14	7	1	2	33	0	2	1	2	62
10. Tetor	20	3	3	0	31	2	1	1	1	62
11. Nëntor	23	9	1	0	19	6	0	0	3	61
Dhjetor	19	8	1	1	24	3	0	1	1	58
Aktivitetet për muaj	280	97	12	7	356	57	5	12	22	
Numri i përgjithshëm i aktiviteteve për vitin 2019										845

Në këtë tabelë mund ti shihni titujt e lajmeve, njoftimeve, thirrjeve dhe ftesave të cilat janë publikuar në uebfaqe për çdo muaj përgjatë gjithë vitit 2019.

1. Janar	Aktivitetet
01.01.2019	Ditë pushimi Viti i Ri 2019
02.01.2019	Ditë pushimi Viti i Ri 2019
03.01.2019	
04.01.2019	
05.01.2019	
06.01.2019	
07.01.2019	Ditë pushimi
08.01.2019	1. Për të 18-tin vit më radhë qytetarët e fshatit Dejnë dhurojnë gjak 2. Kryetari Smajl Latifi, nënshkruan urdhëresën për ndalimin e vrasjes, keqtrajtimit dhe organizimin e garave të kundërligjshme të kafshëve
09.01.2019	1. Gjendja e rrugëve për momentin në komunën e Rahovecit është stabile 2. Mbledhja e parë e Komitetit për Komunitete në komunën e Rahovecit do të mbahet me 17 Janar 2019
10.01.2019	1. Mbledhja e parë e KPF-së për vitin 2019 në komunën e Rahovecit do të mbahet me 18 Janar
11.01.2019	1. Komunikatë për gjendjen e rrugëve në komunën e Rahovecit
12.01.2019	
13.01.2019	
14.01.2019	
15.01.2019	1. Njoftim për qytetarët e komunës së Rahovecit për organizimin e Debatit publik me temë Definimi i variantit më të favorshëm të projektit të Autostradës Istog-Pejë-Deçan-Gjakovë-Prizren 2. Njoftim nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për ndërmarrjen e veprimeve për prerjen e drunjëve që janë në pronësi private dhe publike 3. Publikohet raporti vjetor punës së Qeverisë Komunale të Rahovecit për periudhën Janar-Dhjetor 2018
16.01.2019	
17.01.2019	1. Është mbajtur takimi i parë i Ekipit Profesional për Monitorim dhe Vlerësim

	2.Është mbajtur mbledhja e parë e Komiteti për Komunitete për vitin 2019 3.Njoftimi dhe agenda e 20 vjetorit të rënies së Dëshmoreve Fitim Duraku dhe Skender Rexhepi
18.01.2019	1.Njoftim për qytetarë për takim me përfaqësuesin e Institucionit të Avokatit të Popullit 2.U mbajt mbledhja e parë e Komitetit për Politikë dhe Financa në komunën e Rahovecit 3.Në kuadër të manifestimit tradicional kulturor e përkujtimor “Flaka e Janarit” DKRS shpall konkurs për art letrar, art pamor (figurativ) dhe film dokumentar 4.Mbledhja e parë e rregullt e kuvendit komunal të Rahovecit mbahet më 28 Janar 2019
19.01.2019	
20.01.2019	
21.01.2019	1. Kryetari Latifi bën thirrje për të gjithë mësimdhënësit që pas vendimit të kryeministrit, Ramush Haradinaj, nga sot t’i rikthehen procesit mësimor 2. Thirrje për pagesa direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë dhe therjet e raportuara të gjedhit për tremujorin e katërt (TM4) 2018 3. Njoftim nga drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm për organizimin e sesionit informues për grande „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar (PZHRB 2019)“ 4. Përkujtohen Dëshmorët e Kombit, Fitim Duraku dhe Skender Rexhepi 5.Fjalimi i kryetarit Latifi në 20-vjetorin kushtuar dëshmorëve të kombit Skender Rexhepit dhe Fitim Durakut
22.01.2019	
23.01.2019	1. Njoftim për qytetarët e komunës së Rahovecit për shtyrjen e datës së organizimit të Debatit publik për definimin e variantit më të favorshëm të projektit të Autostradës Istog-Pejë-Deçan-Gjakovë-Rahovec-Prizren 2.Mbledhja e parë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në komunën e Rahovecit mbahet me 29 Janar 2019 3.Njoftim për organizimin e aktiviteteve tradicionale kulturore e përkujtimore “Flaka e Janarit”
24.01.2019	
25.01.2019	1.Njoftim për organizimin e aktiviteteve tradicionale kulturore e përkujtimore “Flaka e Janarit”
26.01.2019	
27.01.2019	
28.01.2019	1.Fjala e kryetarit të komunës, Smajl Latifi në manifestimin qendror “Flaka e Janarit” 2.U mbajt mbledhja e parë e rregullt e kuvendit komunal të Rahovecit për vitin 2019 3.Njoftim nga Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm për organizimin e debati publik me teme krijimin e zonës ekonomike
29.01.2019	1.Mbledhja e dytë e Komitetit për Komunitete në komunën e Rahovecit do të mbahet me 5 Shkurt 2.U mbajt mbledhja e parë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) në Rahovec për vitin 2019 3.Bjondina Kleqka drejtoreshë e DKRS-së vizitoi punimet në palestrën sportive “Mizahir Isma” në qytetin e Rahovecit 4.Fjalimi i kryetarit të komunës Smajl Latifi në 20-vjetorin e rënies së dëshmorit Sahit Krasniqi
30.01.2019	1. Njoftim nga drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe IADK për organizimin e sesionit informues “Ngritja e kapaciteteve profesionale të rinjëve në sektorin e bujqësisë”
31.01.2019	1.Mbahet takimi i dytë i Ekipit Profesional për Monitorim dhe Vlerësim(EPMV) të themeluar nga DKA
	Totali i aktiviteteve për muajin Janar 2019 është 44, 34 lajme, 10 njoftime
2.Shkurt	Aktivitetet
01.02.2019	1.Njoftim për Projektin për Stabilizimin e Komuniteteve III (EU-CSP III) 2.Kryetari Latifi vizitoi bibliotekën komunale “Sylejman Krasniqi” dhe muzeun e qytetit
02.02.2019	
03.02.2019	
04.02.2019	1.U mbajt debat publik me qytetarë për definimin e variantit më të favorshëm të projektit të Autostradës Istog-Pejë-Deçan-Gjakovë-Rahovec-Prizren
05.02.2019	1.Kryetari Latifi ka pritur në takim arkitekt e rinjë të komunës së Rahovecit
06.02.2019	
07.02.2019	1.Mbledhja e dytë e KPF-së për vitin 2019 në komunën e Rahovecit do të mbahet me 14 Shkurt 2.Mbahet sesion informues për projektin “Ngritja e kapaciteteve profesionale të rinjëve në sektorin e bujqësisë”
08.02.2019	1.Shpallje nga IADK, për punë praktike për student të fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë, fakulteti i Teknologjisë Ushqimore në Mitrovicë si dhe fakultetet tjera me fushëveprim në bujqësi 2.Me rastin e 11-të vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në komunën e Rahovecit njofton qytetarët për organizimin e aktiviteteve të shumta kulturore dhe sportive 3.Ftesë publike nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në komunën e Rahovecit për subvencionimin e OJQ-ve dhe individëve për projektet sportive për vitin 2019
09.02.2019	
10.02.2019	

11.02.2019	
12.02.2019	
13.02.2019	1.Takimi i parë i Kryetarit të Komunës së Rahovecit, z. Smajl Latifi me punonjësit e Administratës Komunale për vitin 2019 2.Agjenda e aktiviteteve për 17 shkurt 2019
14.02.2019	
15.02.2019	
16.02.2019	
17.02.2019	
18.02.2019	
19.02.2019	1.Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës u shënua me shumë aktivitete në Komunën e Rahovecit 2.Kryetari i Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi priti në takim kryetarët e komunave nga Frascineto, z. Angelo Catapano dhe Civiata, z. Alessandro Tooci, të Italisë 3.Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike z. Përparim Krasniqi, priti në takim përfaqësuesin e UNDP-së z.Glen Hearn 4.Kryetari i Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi priti në takim zëvendës Ministren e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal znj. Magbule Shkodra
20.02.2019	
21.02.2019	1.Kryetari i Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi priti në takim Komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, të Batalionit të dytë në Istog, z. Astrit Haliti 2.Njoftim
22.02.2019	1.Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z.Kujtim Gashi viziton Palestrën Sportive, "Mizair Isma", në Rahovec
23.02.2019	
24.02.2019	
25.02.2019	
26.02.2019	1. Në uebfaqe e kam publikuar dokumentin e publikuar nga KDI për Transparometri komunal Janar-Dhjetor-2018. 2. KDI ka publikuar "Transparometrin komunal" edhe për gjatë komuna tjera të Kosovës, komuna e Rahovecit radhitet e dyta në dy regjione atë të Prizrenit dhe të Gjakovës 3. Kanë rifilluar sot punimet për vazhdimin e projektit për ndërtimin e tregut modern të rrushit në Rahovec 4.Njoftim për qytetarë për takim me përfaqësuesin e Institucionit të Avokatit të Popullit
27.02.2019	1.Komuna e Rahovecit dhe Qendra Grumbulluese e Frutave dhe Perimeve "Agrocelina" organizojnë punëtori me temë "Oferta për Sezonën 2019" 2.U mbajt mbledhja e dytë e rregullt e kuvendit komunal të Rahovecit për vitin 2019
28.02.2019	1.Inauguruohet objekti i ri i Palestrës Sportive "Mizahir Isma" në Qytetin e Rahovecit 2.Kryetari Latifi takohet me inspektorët e komunës së Rahovecit, diskutojnë për inspektimin e ndërtimeve, ambientit, lokaleve afariste dhe hapësirat publike
Totali i aktiviteteve për muajin Shkurt 2019 është 26, 3 njoftime , 1 ftesë dhe 22 lajme	
3.Mars	Aktivitetet
01.03.2019	1.Kryetari i Komunës së Rahovecit priti në takim Ministrin e Mbrojtjes, z.Rrustem Berisha 2.Drejtori komunal i Arsimit mbajti takim me drejtoret e shkollave, diskutojnë për mënyrën e kompensimit të orëve mësimore të humbura gjatë grevës 3.Njoftim për mbajtjen e debatit publik për Draft Rregulloren për Realizimin e të Drejtave të Fëmijëve
02.03.2019	
03.03.2019	
04.03.2019	1.Thirrje për aplikim nga drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport në komunën e Rahovecit për OJQ
05.03.2019	1.Takimi i parë i Kryetarit të Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi me punonjësit e QKMF-së, "Dr. Fahredin Hoti"
06.03.2019	1.Kryetari i Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi bëri homazhe në varrezat e dëshmorëve për nder të shënimit të 21 vjetorit të "Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare"
07.03.2019	1.Në Komunën e Rahovecit shënohet 7 Marsi Dita e Mësuesit 2.U vu gurthemeli i Shkollës Fillore "Haki Stërmilli ", në fshatin Reti të Rahovecit 3.Inaugurohet salla sportive e Shkollës së Mesme, "Ukshin Hoti", në Krushë të Madhe
08.03.2019	
09.03.2019	
10.03.2019	
11.03.2019	1.Njoftim për mbajtjen e mbledhjen së tretë të rregullt të Komiteti për Politik dhe Financa në Komunën e Rahovecit për vitin 2019
12.03.2019	1.Komuna e Rahovecit dhe "Caritas Kosova" nënshkruajnë kontratë "Shërbime për realizimin e vitalizimit të infrastrukturës për funksionalizimin e projektit shtetërit shtëpiak" 2.Kryetari Latifi ka pritur në takim Komandantin e JRD-së, kolonelin turk, Bahadur Özgür Cengiz

13.03.2019	1.Forca e Sigurisë së Kosovës, Batalioni i dytë i Brigadës për reagim të shpejtë, mbajti konferencën specifike për organizimin e ushtrimit fushor që do të mbahet në qershor 2019
14.03.2019	1.Njoftim nga Drejtoria për Kulturë Rinë dhe Sport, për organizimin e Ditës Botërore të Poezisë 2.Lista me emrat e 92 studentëve përfitues të bursave komunale për vitin akademik 2018/2019
15.03.2019	1.Njoftim nga Kryetari i Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi për organizimin e diskutimeve publike me qytetarë të Komunës së Rahovecit 2.U mbajt mbledhja e dytë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Rahovec për vitin 2019, situata u vlerësua e qetë, stabile dhe e qëndrueshme
16.03.2019	
17.03.2019	
18.03.2019	1.Njoftim për shënimin e përvjetorit të 20-të të masakrës së fshatit Krushë e Madhe të bërë nga forcat serbe me 26 Mars 1999 2.Njoftim nga DBPZHR për orarin e repelimit të kafshëve shtëpiake në Komunën e Rahovecit kundër sëmundjes Ethet Hemorragjike (Krime Kongo)
19.03.2019	1.U mbajt mbledhja e tretë e Komitetit për Politikë dhe Financa në komunën e Rahovecit
20.03.2019	1.Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka hapur thirrjen për OJQ-të dhe shoqata që zhvillojnë aktivitete në fushën e mirëqenies sociale dhe ofrojnë shërbime sociale dhe familjare 2.Komuna e Rahovecit dhe zyra Japoneze në Kosovë kanë nënshkruar kontratë për donacion në vlerë prej mbi 75.000 euro 3.Kryetari Latifi mbajti takim me kryetarët e lagjeve dhe fshatrave, diskutojnë për organizimin e diskutimeve publike me qytetarë 4.Mbahet takim me të gjithë drejtorët e shkollave të komunës së Rahovecit
21.03.2019	1.Mbledhja e tretë e rregullt e kuvendit komunal të Rahovecit mbahet 29 Mars 2019 2.Në Rahovec u shënuar, 21 Marsi -Dita Botërore e Poezisë 3.Njoftim – Programi (Agjenda) i mbajtjes së tubimeve përkujtimore 4.Njoftim nga DBPZHR për orarin e repelimit të kafshëve shtëpiake në Komunën e Rahovecit kundër sëmundjes Ethet Hemorragjike (Krime Kongo)
22.03.2019	1.Vazhdon pritja e qytetarëve në takim nga kryetari i komunës, Smajl Latifi
23.03.2019	
24.03.2019	
25.03.2019	1.Shënohet 20-të vjetori i të rënëve gjatë vitit 1999 në fshatrat, Celinë, Fortesë dhe Brstoc të Komunës së Rahovecit
26.03.2019	1.Përkujtohet 20 vjetori i masakrës në Krushë të Madhe
27.03.2019	1.Njoftim për organizimin e përvjetorit të 20-të të rënies së Dëshmorëve të Kombit, Shefki Thaqi dhe Enver Duraku
28.03.2019	1.Njoftim për media nga Komuna e Rahovecit për mbajtjen e tubimit përkujtimor në fshatin Pastasellë 2.Qytetarët priten në takim nga kryetari, Smajl Latifi
29.03.2019	1.Njoftim për media nga Komuna e Rahovecit për mbajtjen e tubimit përkujtimor në fshatin Oterushë 2.U mbajt mbledhja e tretë e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit 3.Kryetari i komunës, Smajl Latifi nënshkruan kontratat për ndarjen e mjeteve financiare për mbështetje në fushën e sportit me vlerë të përgjithshme prej 82 mijë euro
30.03.2019	
31.03.2019	
	Totali i aktiviteteve për muajin Mars 2019 është 37,11 njoftime , 1 thirrje ftesë dhe 25 lajme
4.Prill	Aktivitetet
01.04.2019	1.Njoftim për mbajtjen e debatit publik për Draft Rregulloren rreth mënyrës dhe kushteve të shfrytëzimit të palestrës së sporteve “MIZAHIR ISMA” në Rahovec
02.04.2019	1.Takimi i drejtoreshave me qëllim të shkëmbimit të përvojave për çështjet të kulturës, rinisë dhe sportit 2.Përkujtohen dëshmorët dhe martirët në fshatrat Nagac dhe Hoçë e Vogël
03.04.2019	
04.04.2019	1.Kryetari Latifi takon humanistin Halil Kastrati, bisedojnë për ndërtimin e 7 shtëpive për persona në nevojë
05.04.2019	1.Njoftim për qytetarë se me 9 Prill 2019 administrata komunale për nder të Ditës së Kushtetutës së Republikës së Kosovës nuk do të punoj 2.Studentët përfitues të bursave komunale priten në takim nga kryetar i komunës, Smajl Latifi 3.Njoftim nga DKR-së për dashamirësit e artit skenik për shfaqjen e komedisë “Iku autobusi”
06.04.2019	
07.04.2019	
08.04.2019	
09.04.2019	
10.04.2019	1.Njoftim për shënimin e 20-të vjetorit të rënies heroike të dëshmorëve Dalip I. Behra dhe Bekim I. Gashi nga Krusha e Madhe

	2.Njoftim për shënimin e 20-të vjetorit të të rënëve në fshatin Potoqan i Ulët 3.Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së katërt të rregullt të Komiteti për Politik dhe Financa në Komunën e Rahovecit për vitin 2019
11.04.2019	1.Sot, kanë filluar punimet e projektit të pastrimit, në brezin rrugor, Gexhë, Malësi e Vogël, Ratkoc, Dejnë, Dobidol, Çifllak dhe Kramovik 2.Mbahet takim në mes të zyrtarëve komunal dhe zyrtarëve të ARPL-së 3.Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi,, në Rahovec pajiset me tituj të ri
12.04.2019	1. Përkujtohen katër dëshmorët dhe tre martirët në fshatin Potoqan i Poshtëm 2. Kryetari i Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi së bashku me Nënkryetarin, z.Fatmir Iska kanë pritur në takim Komandantin e ri të Stacionit Policor në Rahovec, z.Fazli Morina!
13.04.2019	
14.04.2019	
15.04.2019	1. Ka filluar sot aksioni për heqjen e mbeturinave në fshatin Çifllak, përgjatë lumit Drini i Bardhë 2.Sot Kryetari i Komunës e Rahovecit, z.Smajl Latifi ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me ministrin e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, z.Rasim Demiri 3.U mbajt debat publik për Draft Rregulloren rreth mënyrës dhe kushteve të shfrytëzimit të palestrës së sporteve "MIZAHIR ISMA" në Rahovec 4. Mbledhja e tretë e Komitetit për Komunitete në komunën e Rahovecit do të mbahet me 26 Prill 2019
16.04.2019	1.Njoftim për organizimin e tubimit përkujtimor në nderim të dëshmorëve të kombit Visar Hoti dhe Safet Latifi 2.Njoftim nga DBPZHR për bletarë të komunës së Rahovecit 3.Njoftim nga DKRS-së për organizimin e aktiviteteve për shënimin e Ditës Botërore të Trashëgimisë Kulturore
17.04.2019	1.Njoftim nga DKRS-së për organizimin e shfaqjes Forum Teatër "Stigma-Kërko të drejtën tënde" 2.Vazhdojnë përgatitjet për organizimin e ushtrimit fushor Ujku 02/19 3.Nis ndërtimi i trotuarit në fshatin Sopniq
18.04.2019	1.Kryetari i Komunës së Rahovecit,z.Smajl Latifi dhe ministri i Ministris për Kulturë, Rini dhe Sport, z.Kujtim Gashi nënshkruajtën tri memorandum bashkëpunimi
19.04.2019	1.Përkujtohen dëshmorët Visar Hoti dhe Safet Latifi 2.Në Rahovec shënohet Dita Ndërkombëtare e Monumenteve 3.U mbajt mbledhja e katërt e rregullt e Komitetit për Politik dhe Financa në Komunën e Rahovecit për vitin 2019 4.Njoftim nga DKRS, për shënimin e 23 prillit Ditës Botërore të Librit 5.Njoftim publik lidhur me mbajtjen e mbledhjes së katërt të rregullt të Kuvendit Komunal të Rahovecit
20.04.2019	
21.04.2019	
22.04.2019	
23.04.2019	1.Komuna e Rahovecit vazhdon aktivitetet për shënimin e 22 Prillit Ditës Ndërkombëtare të Tokës 2.Njoftim publik për mbajtjen e mbledhjes së tretë të rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në komunën e Rahovecit 3.N J O F T I M Në Shkollën e Mesme, "Ukshin Hoti" në Krushë të Madhe u shënuar Dita Botërore e Librit
24.04.2019	1.Komuna e Rahovecit shpallet më transparente në rajonin e Gjakovës sipas Institutit për politika zhvillimore-INDEP 2.Drejtori i BPZHR-së, Berat Duraku ka pritur në takim përfaqësuesit e Bankës Botërore, me të cilët ka biseduar për sigurimin e gjashtë produkteve bujqësore 3.N J O F T I M Thirrje për fermer të Komunës së Rahovecit
25.04.2019	1.Kryetari Latifi takohet me fermer, ekspert të BE-së dhe të MPZHR-së, bisedojnë për plasminë e prodhimeve të bujqve në tregun e shteteve të Bashkimit Evropian 2.Është mbajtur mbledhja e tretë e rregullt e Komiteti për Komunitete për vitin 2019
26.04.2019	1.N J O F T I M 2.Njoftim për organizimin e 27 Prillit-Ditës së të zhdururve të Kosovës
27.04.2019	
28.04.2019	
29.04.2019	
30.04.2019	1.Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural publikon thirrjen për aplikim për përkrahje të fermerëve me mekanizëm bujqësore 2.U mbajt mbledhja e katërt e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit
	Totali i aktiviteteve për muajin Prill 2019 është 42, 15 njoftime , 2 thirrje ftesë dhe 25 lajme
5.Maj	Aktivitetet
01.05.2019	
02.05.2019	1.Kryetari i Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi takon qytetarët 2.Njoftim për ndarjen e subvencioneve për OJQ nga Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport në komunën e Rahovecit

	3.Njoftim për ndarjen e subvencioneve për OJQ nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale në komunën e Rahovecit 4.Komuna e Rahovecit dhe "SHELL KOSOVA", nënshkruajnë Memorandum Mirëkuptimi për zbritjen e çmimit të naftës për fermer
03.05.2019	1.F T E S Ë
04.05.2019	
05.05.2019	
06.05.2019	1.Për nder të Javës së Heronjve dhe Dëshmorëve të Komunës së Rahovecit gjatë ditës së djeshme u bën homazhe dhe nderime pranë varrezave të dëshmorëve të Komunës së Rahovecit 2.Kryetari i Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi sot ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me ministrin e Ministrisë së Infrastrukturës, z.Pal Lekaj
07.05.2019	1.Komuna e Rahovecit renditet e dyta sa i përket "Indeksit të konkurrueshmërisë së komunave" 2.Kryetari Latifi nënshkruan vendimin për aprovimin e Kodit Komunal të Etikës për zyrtarët e Komunës së Rahovecit
08.05.2019	1.Shfaqja "Stigma-Kërko të drejtën tënde" jepet me 10 maj 2019 në ora 12:30 në Shtëpinë e Kulturës "Muhamet Malsori", në Krushë të Madhe
09.05.2019	
10.05.2019	1.Nën përkuqjesjen e Kryetarit të Komunës së Rahovecit, z. Smajl Latifi në bashkëpunim me OVL e UÇK-ës në Rahovec, duke nisur nga nesër, më 11 maj e deri më 12 maj, do të zbulohen pllakat përkujtimore për nder të "Javës Dëshmorëve të Komunës së Rahovecit" 2.Ftesë për media nga komuna e Rahoveci për organizimin e tryezës shkencore për festivalin folklorik "Anadrinia Jehon"
11.05.2019	
12.05.2019	
13.05.2019	1.U mbajt Akademi Përkujtimore për nder të ditës së Dëshmorëve të Kombit në Komunën e Rahovecit 2.Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale publikon thirrjen për aplikim për mbështetje në ndërtimin e shtëpive 3.Njoftim nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim 4.Njoftim për organizimin e akademisë Politike Shkencor për veprimtarin Ukshin Hoti 5.Njoftim për mbajtjen e mbledhjen së pestë të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa në Komunën e Rahovecit
14.05.2019	1.Me homazhe dhe nderime u shënuar 21-vjetori i rënies së dëshmorit Mehedin Morina nga fshati Gllareva e Klinës
15.05.2019	1.Komuna e Rahovecit renditet e katërta me 78.17 % për arritjen e përgjithshme të performancës komunale 2.U mbajt stërvitje me nxënës për vetëdijësim dhe mbrojtje nga tërmetet
16.05.2019	1.Njoftim nga DBPZHR për orarin e repelimit të kafshëve shtëpiake në Komunën e Rahovecit 2. Në Prizren u shënuar 20-vjetori i zhdukjes së veprimtarit Ukshin Hoti
17.05.2019	
18.05.2019	
19.05.2019	
20.05.2019	1.Konkurs publik nga Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për shënimin e 5 Qershorit-Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit 2.Komuna e Rahovecit mbështet 16 OJQ me mjete financiare në vlerë prej 19 mijë e 100 euro
21.05.2019	1.U mbajt mbledhja e pestë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa në Komunën e Rahovecit për vitin 2019
22.05.2019	1.Nis transferimi i mjeteve financiare për grupin e parë për 293 fermerë në vlerë prej 301,621.10 euro 2.Njoftim për shënimin e 21 vjetorit të rënies heroike të heroit të Kosovës, Feim.A.Gashi 3.Njoftim për fermer nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për hapjen periudhën e aplikimit për grante në bujqësi nga Ministria e Bujqësisë
23.05.2019	1.Kryetari Latifi priti në takim piktorin nga Rahoveci, Defrim Jupa 2.Njoftim publik për mbajtjen e mbledhjes së pestë të rregullt të Kuvendit Komunal të Rahovecit
24.05.2019	1.Zyra e BE-së dhe veraria "Biopak", kanë organizuar tryezën "Verërat e Kosovës: kualitet për tregun e BE-së, standardet e BE-së, prodhimi dhe mundësitë e eksportit"
25.05.2019	
26.05.2019	
27.05.2019	1.Nesër Komuna e Rahovecit fillon aksionin për largimin e mbeturinave 2.Komuna e Rahovecit shënon "Ditën Olimpikë" 3.Njoftim për qytetarë për takim me përfaqësuesin e Institucionit të Avokatit të Popullit
28.05.2019	1.Në 21-vjetorin e rënies së Heroit të Kombit Feim Gashi, është zbuluar pllaka me të cilën u emërua Qendra Kulturorë në fshatin Drenoc 2.U bënë nderime dhe homazhe me rastin e përvjetorit të 20-të, të rënies së dëshmorëve të Kombit Sadedin Hajda dhe Mexhit Mustafa, në Hamoc 3.Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi ka pritur në takim zëvendës avokaten e Popullit, Naile Alaj 4.U shënuar Dita e Qendrës së Kulturës "Mensur Zyberaj" në Rahovec 5.Komuna e Rahovecit ka filluar aksionin për largimin e mbeturinave

29.05.2019	1.Njoftimi për organizimin e aktiviteteve për shënimin e 1 Qershorit-Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve 2.Vazhdon aksioni për pastrimin e ambientit në Komunën e Rahovecit 3.Komuna e Rahovecit në bashkëpunim me Kompanitë Ekodrinia dhe Njesinë Ambienti në Rahovec kanë vazhduar aksionin e largimit të mbeturinave, në rrugën Rahovec-Drenoc, ku ka filluar të eliminohet deponia më e madhe e mbeturinave e cila gjendet në rrugën Rahovec-Drenoc, tek vendi i quajtur Ura e Drenocit
30.05.2019	1.Kryetari i Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi takon qytetarët
31.05.2019	1.Kryetari i Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi priti në takim në zyrën e tij Drejtorin e Spitalit të Përgjithshëm të Prizrenit, Dr.Afrim Avdaj 2.U mbajt takimi i parë i Këshillit Organizues për nder të 20 vjetorit të Ditës së Çlirimit në Rahovec 3.U mbajt mbledhja e pestë e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit
Totali i aktiviteteve për muajin Maj 2019 është 46, 12 njoftime , 2 ftesë dhe 32 lajme	
6.Qershor	Aktivitetet
01.06.2019	
02.06.2019	
03.06.2019	1.Komuna e Rahovecit bashkë me bizneset: Eurofood, KAG dhe QTX kanë dhuruar rreth 100 pako, familjeve me vështërsi ekonomike, për festën e Bajramit 2.Njoftim për organizimin e debatit publik për Draft Rregulloren Komunale për Transparencë 3.Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim përmes ekipeve në terren vazhdimisht janë duke punuar në pastrimin e hapësirave, për shkak të reshjeve të shumta të shiut 4.Për herë të parë, me qëllim të lehtësimit të procedurave për fermerët tanë, ka filluar aplikimi i fermerëve për subvencione në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, përveç Rahovecit
04.06.2019	
05.06.2019	1.Njoftim publik për mbajtjen e mbledhjes së katërt të rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në komunën e Rahovecit 2.Drejtorja e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit ka ndarë dy çmime që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ambientit
